




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-02/DPK Nr Prot 01-452/16
 Dep. 06 Br Prot 05-02-2016
 Nr. i faq. 06 Data 05-02-2016
 Broj stranica 06 Datum 05-02-2016
 Nr. pages 06 Date 05-02-2016

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04.02.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKI-03-02-3475/14
PËR/ZA/TO:	Znj. Hana Bajrami-Rexhepi, Kryeshef Ekzekutiv, u.d. ARDA
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	OPINION lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit

E nderuara znj. Bajrami-Rexhepi,

Për rastin me nr/AKK-03-02-3475/15, që lidhet me shkresën tuaj të datës 23.11.2015, ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Pyetja e juaj konkrete ka të bëjë me një situatë në të cilën keni hedhë dyshimin për konflikt interesi, për Anëtarët e Kuvendit të Asociacionit të Agjencioneve për Zhvillim Rajonal “ARDA” të cilët në të njejtën kohë janë Kryetarë të Komunave përkatëse ?

Lidhur me këtë, Agjencioni kundër Korrupsion lëshon këtë:

OPINION

- I. Nuk është konflikt i interesit faktik për Kryetarët e Komunave të qenurit e tyre për Anëtar të Kuvendit të OJQ-së “Asociacioni i Agjencive për Zhvillim Rajonal” – ARDA. Kjo në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) dhe informacioneve zyrtare (Statutet) nga Asociacioni i Agjencioneve për Zhvillim Rajonal (ARDA).
- II. Kryetarët e Komunave – Anëtarë të këtyre OJQ-ve, mund të kenë konflikt interesi “rast për rast”, por në situata të tilla ata janë të obliguar që ta parandalojnë atë duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe statutore.
- III. Për të evituar konfliktin “rast për rast” të interesit, Agjencia kundër Korrupsionit jep rekomandimet e veta.

ARSYETIM

I. Konstatimi i Agjencisë kundër Korrupsion si në këtë dispozitiv del duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pastaj, informacionet e marra në Agjencioni për Zhvillim Rajonal “ARDA” (Statuti i ARDA-së dhe Statutet e Agjencioneve për Zhvillim Rajonal, AZHR-ve), analizës së bazës tjetër ligjore në lidhje me këtë çështje dhe konsultimeve me disa nga zyrtarët e lartë të përfshirë në këtë proces.

Obligimi i zyrtarëve të lartë për mbrojtje të interesit publik del edhe nga Parimet e veprimit të tyre që janë të parapara në Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit. Konkretisht në nenin 7 paragrafi 1, në të cilin shprehimisht thuhet: *”Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar”*.

Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (P.K.I.) çështjen e anëtarimit të zyrtarëve të lartë në organizata joqeveritare e ka rregulluar në mënyrë specifike në nenin 11 paragrafi 1 dhe 2, në të cilat thuhet si vijon:

1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit, dhe të ngjashme.

2. Organizata joqeveritare me anëtar të organit drejtues nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të përfitoj mjete nga buxheti i Kosovës nëse anëtari i organit drejtues të organizatës joqeveritare, në cilësinë e zyrtarit, ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në vendimmarrje, me rastin e vendosjes për Organizatat Joqeveritare përfituese nga mjetet e buxhetit të Kosovës.

Ndërsa, kur të merren parasysh Statutet e Agjencioneve për Zhvillim Rajonal, pesë sosh (Qendra, Veri, Lindje, Perendim, Jug), atëherë në to shihet se shprehimisht është përcaktuar që themelues të këtyre organizatave/shoqatave, të quajtuara Agjenci, janë Komunitetet përkatëse në bazë të rajonit dhe se ato përfaqësohen nga Kryetarët e Komunave.

D.m.th., kjo pozitë nuk lidhet me emrin, por lidhet me funksionet, që me fjalë të tjera i bie që përfaqësimi i tyre në Kuvend bëhet sipas detyres zyrtare (ex officio).

Kjo pastaj ndërlidhet me dispozitën nga Nenin 16 paragrafi 1, i Ligjit për P.K.I. sipas së cilës Zyrtari i lartë publik përjashtohet nga kufizimi i ushtrimit të funksioneve tjera krahas funksionit të tij publik në rastet kur një funksion (pozitë) i/e tillë i dedikohet për shkak të funksionit bazë.

Në Statutet e AZHR-ve konstatohet se këto organizata janë jo-profitabile dhe ato nuk bëjnë shpërndarjen e çfardo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ, e as që do të krijojnë

beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorët, apo ndonjë anëtar të shoqatës, ose donator të OJQ-së.

Agjencia kundër Korrupsion ka konstatuar se të qenurit e Kryetarëve të Komunave përkatëse për Anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Agjencioneve për Zhvillim Rajonal “ARDA” bazen e vet e ka në Statutin e kësaj organizate. Pikërisht te Neni 3 kur shkruhet për themeluesit e organizatës dhe te Neni 8, kur shkruhet për përbërjen e Kuvendit.

Në Nenin 3 të Statutit të Asociacionit të Agjencioneve për Zhvillim Rajonal (ARDA) thuhet se themelues të saj janë pesë AZHR-të rajonale (jug, lindje, perendim, veri dhe qendra), e të cilat në Kuvend përfaqësohen nga Drejtori Ekzekutiv përkatës i seciles nga to, sipas detyrës zyrtare.

Ne Nenin 8, paragrafin 1, në lidhje me përbërjen e Kuvendit, shprehimisht thuhet: *“Kuvendi i ARDA-së përbëhet nga Kryesuesit e Bordeve të AZHR Qendra, AZHR Jugu, AZHR Veriu, AZHR Lindja dhe AZHR Perendimi, një përfaqësues i një Ministrie të caktuar nga Qeveria e Kosovës, Kryesuesi i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kryesuesi i Asociacionit të Komunave Serbe dhe një përfaqësues i Zyrës së BE në Kosovë”.*

Gjithnjë duke u bazuar në Statutin e ARDA-së, kuptojmë se Anëtarët e Kuvendit të ARDA-së janë të obliguar që të gjithë, që si për mbledhjet e rregullta ashtu edhe për ato të jashtëzakonshme të jenë të pranishëm. Në rast se një anëtar i organizatës nuk mund të marr pjesë në takimet e rregullta ose të jashtëzakonshme të Kuvendit, institucioni përkatës (nga neni i cituar me lartë, 8, par.1 i Statutit) duhet ta emroj një person tjetër nga radhët e organit më të lartë udhëheqës të tij që do ta zvendësoj atë (Neni 12, paragrafi 7, i Statutit të ARDA-së).

Edhe vet nocioni i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik atë e përkufizon si gjendje mospajtimi ndërmjet detyrës zyrtare dhe interesave private të çfardo lloj natyre qofshin ato për zyrtarin e lartë. Prandaj, duke qenë se këtu nuk ka interes privat që lidhet me funksionet e Anëtarëve të Kuvendit të ARDA-së që janë Kryetarët e Komunës, këtu nuk ka konflikt faktik të interesit, përveq se mund të ketë konflikt “rast për rast” të interesit të cilin zyrtarët e lartë publik duhet ta deklarojnë.

II. Zyrtarët e lartë publik janë të obliguar që sa herë që kanë njohuri të ekzistimit të konfliktit të interesit privat të tyre, atë ta bëjnë deklarinimin paraprak.

Konflikti i interesit “rast për rast” është i rregulluar me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit.

Por, në situatën konkrete konflikti i interesit është i rregulluar edhe me Statutet e AZHR-ve rajonale si dhe me Statutin e Asociacionit të Agjencioneve për Zhvillim Rajonal (ARDA).

Te Statuti i AZHR-ve rajonale, neni 7, paragrafi 11, thotë:

7.11. Secili anëtar i Bordit të Drejtorëve mund të abstenoj prej votimit për marrjen e vendimeve për çfardo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ekonomik.

Ndërsa Statuti i ARDA-së çështjen e obligimeve për parandalimin e konfliktit të interesit e ka rregulluar edhe më gjerësisht në katër paragrafe të nenit 19. Dhe atë si në vijim:

- 1. Anëtarëve të Kuvendit, Anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës, Kryeshefit Ekzekutiv dhe personelit të organizatës nuk i lejohet pjesëmarrja në vendimmarrje dhe diskutim për çështje kur ai/ajo ose anëtarët e familjes së tij/saj kanë interes të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë ekonomik ose personal të çfardo natyre.*
- 2. Çfardo konflikti i interesit që mund të ketë një anëtar i Kuvendit, anëtar i Bordit Këshillëdhënës, Kryeshef Ekzekutiv, Drejtorët e AZHR-ve ose personeli duhet të deklarohet me shkrim para Kuvendit të ARDA-së.*
- 3. Të gjithë personat që shërbejnë në organizatë duhet të kryejnë detyrat e tyre me lojalitet dhe me kujdes dhe marrin përgjegjësi personale për çfardo shkelje të këtyre detyrimeve.*
- 4. Personeli i ARDA-së nuk do të ushtrojë asnjë profesion tjetër, me pagesë apo pa pagesë, krahas funksionit të tyre siç përkufizohet nga kontrata e tyre. Përgjashtime mund të bëhen vetëm me vendim të miratuar nga shumica prej dy të tretash të anëtarëve të Kuvendit.*

III. Rekomandimet e Agjencisë kundër Korrupsionit për Zyrtarin e lartë publik që të parandaloj konfliktin e interesit “rast për rast” bazohen në tri paragrafët e nenit 13, si dhe në veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë publik, neni 9, të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe atë si në vijim:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë pos tjerash i ndalohen edhe veprimet , si psh : të kërkoj apo pranoj shpërblim, premtim shpërblim lidhur me veprimin e ndërmarr apo mosveprimin që është i obliguar ta ndërmerr në kuadër të ushtrimit të funksionit publik. Pastaj që të kërkoj, përvetësoj, pranoj, shpërblime apo shërbime për vete ose për tjetrin si kompensim të votës së tij në vendimmarrje. Po ashtu i ndalohet që të ndikoj në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit material personal apo të personit në lidhje me te, si dhe i ndalohet që të shfrytëzoj informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo të besueshëm. Çka është më e rëndësishmja , zyrtari i lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij e ka të ndaluar të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyre do t'i përshtaten apo do të favorizojnë intersin e tij privat apo ndonjë personi të afërtë, në dëm të interesit publik.

Agjencioni kundër Korrupsion ju falenderon për bashkëpunimin .

Me respekt,